



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 27

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302

Prishtinë, më 08 nëntor 2018, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Enver Hoti, Haxhi Avdyli, Naser Rugova, Bekim Haxhiu dhe Fikrim Damka.

Munguan: Miljana Nikoliq, Drita Millaku, Flora Brovina dhe Time Kadrijaj.

Të ftuar: Nuk ka pasur.

Pjesëmarrës të tjerë: KDI dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.09.2018;
3. Shqyrtimi i kërkesave të profesionistëve shëndetësorë;
4. Shqyrtimi i projektligjit për Inspektoratin e punës;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 19.09.2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 19.09.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i kërkesave të profesionistëve shëndetësorë

Kryetarja tha se ne, si komision, kemi pranuar disa kërkesa nga profesionistët shëndetësorë lidhur me projektligjin për pagat. Kërkesa kemi pranuar nga Federata e Shëndetësisë-FSSHK, Oda e Farmacisteve të Kosovës-OFK, Grupi i Farmacisteve Specialist, Grupi i Infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë. Të cilët kanë dhënë propozimet tyre, si dhe njëherit kanë kërkuar nga ne, si komision që t'i përkrahim. Ne do t'i shqyrtojmë këto kërkesa dhe bashkërisht do të bëjmë amendament në projektligjin për paga. FSSHK ka mbajtur edhe tryeze lidhur me projektligjin për paga dhe ne që kemi qenë prezentë si deputetë pothuajse të gjithë i kemi përkrahur kërkesat e FSSHK-së. Kërkesë e FSSHK-së ka qenë që për mjeket specialist të gjitha fushat koeficienti të jete 6. Infermieret më bachelor koeficientit të jetë 2.7, ndërsa infermieret me shkollë të mesme 2.2. Për psikologët klinikë koeficienti 2.7. Asociacioni i Mjekeve familjar, kanë kërkuar që specialistet nga lëmi e mjekësisë familjare të trajtohen me koeficient të barabartë me mjeket specialist të gjitha lëmit. Kosovës i mungojnë mjekët e mjekësisë familjare diku mbi 400 mjekë. Kërkesa nga infermierët është që koeficientet të jenë 3.5 për infermierët me bachelor, ndërsa për ata me shkollë të mesme 3.0. Kërkesat e OFK- së janë që të parashihen me qartë kategoria e farmacistëve pasi që nuk është e rregulluar qartë si dhe ka bërë kërkesë, po ashtu që të rriten koeficientet për teknik i farmacisë të jetë 3.5, bachelor koeficienti 4, magjistër ose doktor i farmacisë të jetë me koeficient 4.5, doktor farmacist në specializim koeficienti 4.5 dhe magjistër ose doktor i farmacisë specialist koeficienti të jetë 5.5. Pra, këto janë kërkesat e tyre. Ne duhet shqyrtuar dhe dalim me një propozim konkret si komision për këto kërkesa, si dhe për ato kategoritë të cilat mendojmë se duhet të përkrahën dhe të keni një trajtim dinjitar.

Bekim Haxhiu tha se së bashku me dy deputetët e tjerë z. Fatmir Xhelili dhe Xhevahire Izmaku kemi bërë propozim amendamente për projektligjin për pagat. Pra, ne kemi propozuar një kapitull të ri për pagat për personelin shëndetësor, si dhe shtojcën 1B dhe ri rregullimin e shtojcës 2. Pra, të gjitha këto kërkesa që i prezantove janë të përfshira në propozimin tonë, janë të kategorizuara në mënyrë detaje. Me këtë amendamente ne kemi propozuar që të rregullohet edhe çështja e punës së integruar të mësimdhënësve në QKUK. Ne këtë propozim nuk do të këtë kosto shtesë pasi që bëhet një pagë e vetme nga ajo që aktualisht marrin pagën primare dhe pagën sekondare. Ne kemi bërë një propozim konkret për të gjitha kategoritë që janë përfshirë në shtojcën 1B. Kategorizimi i personelit shëndetësor është bërë duke u bazuar në përgatitjen profesionale, gradën shkencore dhe titullin akademik, ndërsa për pozitat udhëheqëse i shtohen pagës bazë shtesë të parapara me këtë ligj. Ne kemi bërë një amendament të specifikuar dhe detajuar për të gjitha kategoritë e profesionistët shëndetësor dhe në këtë rast kërkojmë mbështetjen e komisionit për amendamentet tona të cilat i plotësojnë edhe kërkesat e profesionistëve shëndetësorë.

Haxhi Avdyli tha se unë personalisht këtë amendament do të përkrahu, po besoj se me këtë amendamente do të përmirësohet gjendja e profesionistëve shëndetësorë pra do të kenë një trajtim dinjitar. Të cilët më të vërtetë kanë qenë të anashkaluar dhe të cilët janë me shkollimin më të lartë të nevojshëm. Të shtojca 1, unë kam vërejtur se pozitat menaxheriale apo drejtuesit e lartë në

shëndetësi siç janë drejtori i QKUSK, QKUK, IKSHP, QKTGJK, si dhe drejtori i spitalit të përgjithshëm të kenë rrogën më të vogël se specialisti. Pra, si është e mundur të stimulohen njerëzit që në të ardhmen të marrë përgjegjësi menaxheriale ku punëtorët të paguhen me shumë se drejtori i tyre. Unë kisha propozuar se drejtuesit e lartë në shëndetësi të parashihet të rritet koeficientit 5.7 apo 5.4. Drejtori i klinikës është përgjegjës për gjithçka në kuadër të asaj klinike dhe si mos të kenë një trajtim dinjitar sa i përket pagave të tyre.

Naser Rugova tha se ky projektligj ka anomalitë e veta dhe ka pasur mos diskutim për specifikat e shkollimit dhe nivelit të përgjegjësisë së specialistëve të fushave të caktuar. Ne, si komision, duhet që në mënyrë racionale t'i artikulojmë kërkesat edhe të sindikatës dhe shoqatave të tjera të profesionistëve shëndetësorë që të paraqesim amendament në projektligjin për pagat. Që profesionistët shëndetësorë të kenë paga dinjitare në të ardhmen. Ne duhet të bisedojmë edhe me ministrin e Financave pasi që kemi vërejtje nga Fondi Monetar për koston e këtij projektligji. Amendamentet që i ka dorëzuar Bekim Haxhiu me kolegët e tjerë deputetët edhe unë do t'i përkrahu, mirëpo ne, si komision, të harmonizojmë qëndrimin dhe të dorëzojmë propozimet tona të artikuluar kërkesat e profesionistëve shëndetësorë.

Enver Hoti tha se edhe unë mbështes punën që kanë bërë kolegët deputetët, pra amendamentet që i kanë dorëzuar për profesionistët shëndetësorë. Ne, si komision, ose duhet t'i përkrahi këto amendamentet ose t'i bëjmë propozimet tona dhe të shqyrtojmë mundësinë që edhe në Komisionin Funkcional t'i prezantojmë këto amendamente dhe të kërkojmë përkrahjen e tyre. Ne duhet të bashkëpunojmë ngushtë, si me ministrin e Financave Komisionin për Administratë edhe Komisionin për Buxhet që të shqyrtohet mundësia e përmirësimit të kësaj situatë, pra, profesionistët shëndetësorë të kenë paga me dinjitet.

Fatmire Kollçaku tha se është rasti që të përmirësohen padrejtësitë që u janë bërë profesionistëve shëndetësorë për paga. Padrejtësi ju është bërë edhe te shkollimi, pra kur kam shkuar për të regjistruar magistraturën më kanë thënë se ti nuk mundesh të marrësh titull më të lartë se sa e ke si doktor. Pra, nuk po na njihet pasi që të kategorizimi kemi mjek specialist me master dhe vetëm mjek specialist. Këtu duhet të bëhet një ndryshim se një fakultet bachelor trevjeçar me atë gjashtë vjeçar nuk janë të njëjtë dhe ne, si komision, duhet të reagojmë dhe ta rregullojmë. Ky propozimi i kolegeve është i mirë i detajuar, mirëpo kemi kohë të shkurtër për të analizuar. I kemi edhe kërkesat e profesionistëve shëndetësorë që po i shqyrtojmë ne, si komision, duhet bashkërisht të vendosim si do të procedojmë.

Fikrim Damka tha se i falënderoj kolegët deputetë në këtë rast Bekimi ka bërë një punë shumë të mirë. Kanë propozuar amendamente profesionale të elaboruara në mënyrë detaje. Mirëpo kam disa pyetje. Keni theksuar se nuk do të ketë kosto shtesë buxheti? Kjo është sipas përlllogarisë së juaja? Unë kam përshtypje se projektligji për pagat do të bëjë një disbalancë me sektorët e tjerë. Mirëpo ne, si komision, për shëndetësi është primare të kujdesim për sektorin për shëndetësi. A ka mundësi amendamentet 4 dhe 5 t' i elaboroni edhe njëherë. Unë kam propozim që si komision të shkojmë me një amendament qoftë edhe të përkrahim kolegët që e kanë dorëzuar.

Bekim Haxhiu tha se kostoja buxhetore të mësimdhënësit janë personel në QKUK, nuk ka kosto buxhetore pasi që ata kanë marrë pagën primare edhe sekondare dhe në propozimin tonë. Këta marrin një pagë bazë në këtë rast paga integrohet në një pagë bazë. Ndërsa të infermierët dhe mamitë ka kosto buxhetore. Pra, propozimi që ka ardhur më 1.9 koeficienti sipas meje është diskriminues dhe ne kemi propozuar rritje. Pra, nuk ka kosto shtesë vetëm të mësimdhënësit. Dhe në këtë rast më lejoni t'ju falënderoj të gjithëve që afruat mbështetjen për amendamentet që i kemi dorëzuar dhe të cilët më të vërtetë do të përmirësojnë dukshëm pagat e profesionisteve shëndetësorë.

Komisioni, pas shqyrtimit dhe diskutimeve të kërkesave të profesionistëve shëndetësorë, vendosi që komisioni të propozojë amendament në projektligjin për paga, si vijon:

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 57, paragrafi 3, të Rregullores së Kuvendit, i propozon këto amendamente në Projektligjin nr.06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik:

Amendamenti 1

Në shtojcën 1. të Projektligjit për Pagat në Sektorin Publik të ndryshohen koeficientet si vijon:

Titulli i pozitës mjek specialist, klasa D3, koeficienti „5” të zëvendësohet me koeficientin „6” , fusha e zbatimit mjek specialist nga të gjitha lëmit në sektorin shëndetësor duke përfshirë mjek specialist të mjekësisë familjare dhe specialistët e stomatologjisë.

Pas titullit mjek specialist të shtohet titulli specialist i farmacisë klinike dhe specialist i kimisë sanitare, të shtohet klasa D7/1 me koeficient 5.5.

Titulli i pozitës mjek në specializim, stomatolog në specializim, farmacist në specializim klasa D6, koeficienti „3.65” të zëvendësohet me koeficientin „4.5” .

Të plotësohet titulli i pozitës me: mjek i përgjithshëm, stomatolog i përgjithshëm, farmacist, inspektor shëndetësor, klasa D7, koeficienti „3.40” të zëvendësohet me koeficientin „4.0” .

Titulli i pozitës fizioterapeut / psikolog klinik, klasa D7, të shtohet koeficienti „3.20”. Fusha e zbatimit me shkollim universitar(3-4 vjeçar) të punësuar në institucione shëndetësore dhe në institucione të tjera ku ushtrohet profesioni përkatës.

Titulli i pozitës Infermier/mami/teknik mjekësor/ 1, klasa D14, koeficienti „2.20” të zëvendësohet me koeficientin „3.0”. Fusha e zbatimit me shkollim bachellër të punësuar në institucione shëndetësore dhe në institucione të tjera ku ushtrohet profesioni përkatës.

Titulli i pozitës Infermier/mami/teknik mjekësor / fizioterapeut 2, klasa D18, koeficienti „1.90” të zëvendësohet me koeficientin „2.4”. Fusha e zbatimit me shkollim të mesëm të punësuar në institucione shëndetësore dhe në institucione të tjera ku ushtrohet profesioni përkatës; teknik i autopsisë.

Titulli i pozitës Ndhmës Infermier/mami/teknik mjekësor, klasa D21, koeficienti „1.70” të zëvendësohet me koeficientin „2.00”. Fusha e zbatimit me shkollim bachellor të punësuar në institucione shëndetësore dhe në institucione të tjera ku ushtrohet profesioni përkatës.

Arsyetim

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka pranuar propozime nga FSSHK, Oda e Farmacistëve dhe nga infermierët, mamitë dhe grupi i farmacistëve specialist të cilët kërkojnë trajtim dinjitar në kuadër të Projektligjit për pagat në sektorin publik.

Komisioni ka shqyrtuar kërkesat e tyre dhe duke pasur parasysh rendësin e sektorit të shëndetësisë dhe largimin e personelit shëndetësor nga Kosova, në mënyrë unanime ka përkrahur kërkesat e tyre dhe ka propozuar amendamentin e shënuar lart dhe kërkon nga deputetët dhe Komisioni Funkcional që ta përkrahë këtë amendament.

Komisioni njëzëri miratoi amendamentin në Projektligjin për Pagat në Sektorin Publik.

4. Shqyrtimi i projektligjit për Inspektoratin e punës

Kryetarja tha se projektligji për Inspektoratin e Punës ka kaluar në lexim të parë dhe ne duhet të vazhdojmë me shqyrtimin pra amendamentimin e këtij projektligji. Ne, sot, po formojmë grupin punues i cili do të vazhdojë me shqyrtimin e tij dhe komisionit do t'i propozojë amendamentet për këtë projektligj.

Komisioni, pasi diskutoi projektligjin për Inspektoratin e Punës, vendosi që të nxjerrë këtë:

Vendim

1. Formohet grupi punues për shqyrtimin e projektligjit për Inspektoratin e Punës dhe komisionit të ja paraqes propozim amendamentet.
2. Përbërja e grupit punues:
 - 2.1. Bekim Haxhiu – kryesues,
 - 2.2. Besa Baftiu – anëtare,
 - 2.3. Enver Hoti – anëtar,
 - 2.4. Naser Rugova – anëtar,
 - 2.5. Drita Millaku – anëtare.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Besa BAFTIU